



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1636 prot.

Tiranë, më 25. 10. 2019

V E N D I M

Nr. 154, Datë 25. 10. 2019

Mbështetur në ligjin Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 92 Regj., datë 30.07.2019, e shtetasit A. M., kundër punonjësve të policisë së Komisariatit të Policisë Nr. 3, Tiranë, me pretendimin diskriminim për shkak të *“identitetit gjinor dhe orientimit seksual”*¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi sqaron se më datë 25.07.2019, ka qënë duke kaluar në zonën mbrapa Hotel “Tirana International”, kur një grup prej 6 personash (meshkuj) i është drejtuar me fjalë fyese, ofenduese, e më pas kanë ushtruar dhunë ndaj tij. Në vijim, ankuesi pretendon se në vendngjarje është paraqitur patrulla e policisë së Komisariatit të Policisë Nr. 3, Tiranë, por nga ana e tyre nuk është kryer asnjë veprim për të identifikuar apo ndaluar autorët e dhunës së ushtruar ndaj tij. Në këto kushte, A. M. është drejtuar pranë ambjenteve të Komisariatit të Policisë Nr. 3, Tiranë, ku ka depozituar një kallëzim penal për ngjarjen e ndodhur. Sipas tij, edhe në ambjentet e Komisariatit Nr. 3, Tiranë, është ndier i ofenduar gjatë kohës që ka paraqitur kallëzimin, nga Oficeri i Policisë Gjyqësore.

Gjithashtu, ankuesi sqaron se më datë 26.07.2019, është paraqitur pranë mjekut ligjor për të kryer ekspertizën e nevojshme, për shkak të dëmtimeve të marra nga dhuna e ushtruar.

¹ Ankuesi deklaron se i përket komunitetit LGBTI.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD;

Në përfundim, ankuesi pretendon se trajtimi i tij në mënyrë të pafavorshme dhe diskriminuese nga ana e punonjësve të policisë së Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë, është bërë për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual. Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, tërheqjen e vëmendjes së punonjësve të Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë, për komunikim sa më etik dhe për trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të personave që i përkasin komunitetit LGBTI.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me anë të shkresës Nr. 1189/1 prot., datë 05.08.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë, ku i ka kërkuar informacion dhe parashtrime rreth pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar dhe megjithë tejkalimin e afatit 30 (tridhjetë ditë) nga ana e tyre, Komisarati i Policisë Nr. 3 Tiranë nuk ka kthyer asnjë informacion shkresor lidhur me sa i është kërkuar nga Komisioneri.

2. Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 171, datë 17.09.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë

³ Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Komisariatit të Policisë Nr. 3, Tiranë, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e shtetasit A. M.”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, më datë 26.07.2019, për të marrë informacion dhe për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit të kryer, inspektorët e KMD-së morën takim me përfaqësuesit e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, Tiranë, A. D., me detyrë Shef i Patrullave të Përgjithshme dhe E. Z., me detyrë Specialist në Hetimin e Krimit të këtij institucioni. Sipas A. D., më datë 25.07.2019 patrulla e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, është njoftuar për një konflikt mes disa personave të ndodhur pranë Hotel Tirana International, ku patrulla përkatëse është paraqitur menjëherë në vendngjarje dhe ka marrë takim me A. M. Nga ana e strukturave të Komisarariatit të Policisë Nr. 3, ishin bërë procedurat përkatëse për identifikimin e personave që kishin ushtruar dhunë ndaj A. M., e më pas ky i fundit ishte orientuar për të paraqitur kallëzim pranë Specialistit të Hetimit të Krimit në Komisariatin e Policisë Nr. 3 Tiranë.

Në vijim të informacionit, E. Z. sqaroi se më datë 25.07.2019, A. M. në prani edhe të shtetasit F. H., ishte paraqitur për të depozituar kallëzimin, pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 3. Sipas procedurave ligjore⁴ të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, i ka marrë kallëzimin përkatës subjektit ankues, në vijim e ka përcjellë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për ndjekjen e veprimeve të mëtejshme. Nga ana e E. Z. u theksua fakti se për asnjë moment ndaj shtetasit A. M. nuk janë përdorur shprehjet e pretenduara prej tij apo shprehje të tjera fyese.

Në përfundim të inspektimit të kryer nga ana e A. D. u theksua se i gjithë informacioni i kërkuar do të vihet në dispozicion të Komisionerit në ditët në vijim.

3. Në vijim të procedurës hetimore, Komisarati i Policisë Nr. 3, Tiranë, me shkresën⁵ Nr. 6395/1 prot., datë 02.10.2019, vuri në dispozicion të KMD-së, informacion shtesë lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi.

Në referim të shkresës së sipërcituar Komisarati i Policisë Nr. 3, Tiranë, sqaroi ndër të tjera se: *“...Nga ana jonë janë bërë verifikimet e duhura ku rezulton se më datë 25.07.2019, rreth orës 02:15, është marrë njoftim nga Salla Operative e Drejtorisë Tiranë, se në rrugën ‘Urani Pano’ janë disa persona që po konfliktohen. Menjëherë ka kaluar autopatrulla e planizuar me shërbim në këtë sektor me punonjësit e policisë Inspektor M. P. dhe V. H., të cilët pasi kanë mbërritur në adresën e mësipërme kanë marrë takim me shtetasin A. M., i cili pasi është intervistuar nga*

⁴ Referuar Nenin 283, pika 2, e Ligjit Nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit” dhe Nenit 293, pika 1 “Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, por jo më vonë se 72 orë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit”

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1189/4 prot., datë 03.10.2019.

punonjësit, i ka informuar se disa persona e kanë goditur dhe janë larguar. Nga ana e punonjësve të policisë është pyetur nëse kishte dëmtime dhe i është ofruar ndihmë për të njoftuar ambulancën dhe dërguar në Spital, por shtetasi A. M., nuk ka pranuar, me pretendimin se ishte mirë dhe nuk kishte probleme. Gjatë intervistimit paraprak është pyetur nëse i njihje personat që ishte konfliktuar dhe është shprehur se nuk i njihje. Është pyetur për karakteristikat e personave që e kishin goditur, kohën e ndodhjes së konfliktit, drejtimin e lëvizjes së autorëve të dyshuar dhe më pas është këshilluar për të bërë kallëzim në komisariat. Autopatrulla ka dhënë në radio karakteristikat e personave, drejtimin e lëvizjes dhe është futur në kontroll territori për kërkimin e tyre, ku pas kërkimeve nuk janë konstatuar personat e dyshuar. Të gjitha veprimet policore me shtetasin A. M., janë rregjistruar me kamerën e trupit nr. 373 dhe pas mbarimit të shërbimit bazë të procedurës standarte të miratuar me urdhër nr. 862, datë 11.09.2018 ‘Për përdorimin e kamerave të trupit, përpunimin dhe ruajtjen dhe administrimin e pamjeve filmike të përfituara nga kamerat e Policisë së Shtetit’, janë shkarkuar dhe ruhen në DVP Tiranë. Rreth orës 03:15, shtetasit A. M. dhe F. H., janë paraqitur në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, ku dhe kanë bërë kallëzim tek Specialisti për Hetimin e Krimeve, Nënkomisar E. Z. dhe materialet procedurale me shkresë Nr. 5505/K, datë 29.07.2019, janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme. Në ambjentet e këtij komisarati nga personeli policor në lidhje me shtetasin A. M. dhe F. H., janë kryer të gjitha veprimet në bazë të procedurave standarte që normojnë punën e tyre dhe nuk ka patur asnjë lloj diskriminimi për asnjë lloj arsye ndaj shtetasve të mësipërm. Të gjitha veprimet e mësipërme janë të dokumentuara si në telefonatën e marrë në sallën operative datë 25.07.2019, në rregjistrimin me kamerat e trupit të punonjësve të policisë, raportin e shërbimit të plotësuar në vendngjarjen, si dhe shkresën përcjellëse me gjithë veprimet procedurale të kryera dhe referimi i materialeve në Prokurori.”

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Nga informacioni i depozituar pranë KMD-së, rezulton se, më datë 25.07.2019, rreth orës 02:15, Salla Operative e Drejtorisë Tiranë, ka njoftuar strukturat përkatëse të Komisarariatit të Policisë Nr. 3, se në rrugën ‘Urani Pano’ po konfliktohen disa persona. Në këto kushte, nga ana e tyre është njoftuar patrulla e cila ishte në shërbim në atë zonë, ku kanë marrë takim me ankuesin. Në momentin që punonjësit e policisë kanë marrë takim me ankuesin, e kanë pyetur atë lidhur me ngjarjen e pretenduar, si dhe i kanë marrë informacion mbi identifikimin e personave që pretendohet se e kanë dhunuar. Gjithashtu, nga ana e strukturave të policisë, i është ofruar ndihmë nëse kërkonte të shoqërohej në ambjentet e një qendre spitalore për tu mjekuar, por është refuzuar nga ana e ankuesit. Pas informacionit të shkëmbyer me ankuesin, punonjësit e policisë kanë dhënë në radio karakteristikat përkatëse të personave që kanë ushtruar dhunë ndaj ankuesit dhe më tej kanë vijuar në kryerjen e kontrollit të zonës për identifikimin e personave të dyshuar.

Sipas informacionit zyrtar të administruar, mbështetur në urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 862, datë 11.09.2018 *“Për përdorimin e kamerave të trupit, përpunimin dhe ruajtjen dhe administrimin e pamjeve filmike të përfituara nga kamerat e Policisë së Shtetit”*, të gjitha veprimet e punonjësve të policisë me ankuesin janë të rregjistruara dhe të dokumentuara. Gjithashtu, janë të dokumentuara edhe në raportin e shërbimit të plotësuar nga punonjësit e patrullës së Komisarariatit të Policisë Nr. 3, Tiranë.

Në vijim, rreth orës 03:15, ankuesi së bashku me shtetasin F. H., janë paraqitur në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, ku dhe kanë paraqitur kallëzimin përkatës për dhunën e ushtruar ndaj tij. Veprimet për marrjen e kallëzimit, pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë, janë kryer nga ana e Specialistit për Hetimin e Krimeve, E. Z. Nga informacioni i vënë në dispozicion, pas administrimit të kallëzimit nga ana e Specialistit për Hetimin e Krimeve, janë kryer hapat procedural në vijim duke përcjellë materialet me shkresë Nr. 5505/K, datë 29.07.2019, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”. Neni 18, i saj shpreh se “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14, Ndalimi i diskriminimit, përcakton se : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

Neni 94 i Ligjit Nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, përcakton se: *“Punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave. Normat dhe rregullat e sjelljes dhe të etikës përcaktohen në Rregulloren e Policisë”*.

Gjithashtu në nenin 117 të Rregullores së Policisë së Shtetit, përcaktohet se: *“Punonjësi i policisë gjatë kohës që është në shërbim dhe jashtë tij sillet në mënyrë të përshtatshme, me*

korrektesë, duke respektuar dinjitetin e gjithësecilit. Në çdo rast punonjësi i policisë i drejtohet qytetarit duke përdorur fjalët e mirësjelljes”.

Për dokumentimin e ngjarjeve, intervistimin apo marrjen e deklarimeve të ndryshme në terren, punonjësit e Policisë së Shtetit janë të pajisur me kamerat e trupit. Në zbatim të pikës 9, Kreu IV i Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 862, datë 11.09.2018 “*Procedura standarde e punës për përdorimin e kamerave të trupit, përpunimin, ruajtjen dhe administrimin e pamjeve filmike të përfituara nga kamerat e Policisë së Shtetit*”, Shërbimet e Policisë së Shtetit kanë detyrimin dhe përgjegjësinë që gjatë kryerjes së detyrave dhe attributeve policore të monitorojnë nëpërmjet kamerave të vendosura në trup, çdo veprim policor gjatë kohës së punës.

Në Kreun V, të Urdhërit të sipërcituar, parashikohet procedura e punës së punonjësve të policisë, që nga momenti i vendosjes së kamerës në trup dhe deri në dokumentimin e ngjarjeve apo marrjen e dëshmive. Referuar pikës 3.7 të këtij Kreu, punonjësi i shërbimit të patrullës në përfundim të shërbimit, plotëson dhe dorëzon tek eprori i drejtëpërdrejtë formularin e përpiluar nga Administratori, në të cilin pasqyrohet i gjithë aktiviteti i patrullës nga fillimi deri në përfundim të shërbimit.

Nga analiza legjisllacionit dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk u siguruan prova për të vërtetuar faktin e përdorimit të shprehjeve ofenduese apo për të konstatuar që subjekti ankues është përballur me një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm nga ana e strukturave të Policisë së Komisariatit Nr. 3, Tiranë, siç ka pretenduar në ankesë.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se strukturat e Komisariatit të Policisë Nr. 3, Tiranë nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e strukturave të Komisariatit të Policisë Nr. 3, Tiranë, për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të orientimit seksual, të A. M., nga ana e punonjësve të policisë së Komisariatit të Policisë Nr. 3, Tiranë.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONER

(Shkaku: Orientimi seksual)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)